



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:909009

Datë: 19.02.2021

Numri i dokumentit: 01520531

**Ac.nr.994/18**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve Kujtim Pasuli, kryetar i kolegjit dhe Nenad Llaziq e Makifete Saliuka - anëtarë, në çështjen juridike të paditëses A.B nga Fshati ..., Komuna e Suharekës, të cilën e përfaqëson me autorizim av. S.S, nga Suhareka, kundër të paditurës Komuna e Suharekës – Drejtoria Komunale e Arsimit në Suharekë, të cilin e përfaqëson Avokati Publik i Komunës, për shkak të anulimit të konkursit dhe aktvendimit, duke vendosur sipas ankesës të paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, C.nr.289/17 të datës 27.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.02.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pa bazuar**, ankesa e paditëses A.B nga fshati ... , Komuna e Suharekës, **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, C.nr.289/17 të datës 27.10.2017.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit, është refuzuar kërkesëpapia e paditëses A.B, nga fshati ..., Komuna e Suharekës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i pabazuar aktvendimi për shpalljen e konkursit nga ana e të paditurës 01.Nr.... të dt. 27.03.2017, si dhe të anulohet konkursi për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2016 – 2017, 05 Nr. ... të Drejtorisë së Arsimit dhe të shpallet konkursi për të njëjtin vend pune sipas kualifikimit dhe standardeve që parasheh ligji, e pabazuar. Nën II të dispozitivit është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë e autorizuara e paditëses av. Sabrije Sylaj, nga Suhareka, për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Aktgjykimit të padrejtë, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë të aprovojë ankesën në tërësi si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e goditur ta prishë dhe çështjen ta kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykate e shkallës së dytë, duke vepruar në kuptim të nenit 194 të Ligjit të procedurës kontestimore, ka vlerësuar aktgjykimin e goditur në kuadër të kufijve të arsyeve të theksuara në ankesë, duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja nëpër mjet të autorizuarës av. Sabrije Sylaj ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi për shpalljen e konkursit nga ana e të paditurës 01 Nr.... të dt. 27.03.2017, si dhe të anulohet konkursi për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2016- 2017, me numër 05 Nr.... të Drejtorisë së arsimit dhe të shpallet konkursi për të njëjtën vend pune sipas kualifikimit dhe standardeve që parasheh ligji dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë ka marrë aktgjykimin më për së afërmi të përshkruar si në dispozitiv, duke gjetur se konkursi është shpallur për plotësimin e vendeve të punës për vitin shkollor 2016/2017, dhe ky konkurs është shpallur komform neni 8 të Ligjit të punës, neni 35 të Ligjit për arsimin para universitar, neni 5 për Ligjin mbi Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm nr. 06/2015. Njëherit këtu e paditura me vendimin e saj ka formuar panelin intervistues dhe ky panel është formuar në përputhje me Ligjin për Arsimin Para universitar dhe konkursit të shpallur nga Drejtoria e Arsimit, ku detyra e këtij paneli ka qenë të bëjë intervistimin e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs dhe të përzgjedh kandidatin më të suksesshëm për plotësimin e vendeve të lira të punës. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara dhe të vlerësuar ka vërtetuar se kandidatja e cila është pranuar në vendin e punës kontestuese ka marrë më së shumti pika, përkatësisht 89 pika. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se ankesa e këtij paditëses për anulimin e konkursit është refuzuar nga e paditura me arsyetim se këtu paditësja nuk i plotëson kushtet e parapara me udhëzimin administrativ nr. 06/2015, mbi normativin e kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm konkretisht neni 5 pika 1.1. Gjykata e shkallës së parë nga aktvendimi i komisionit për zgjidhjen e ankesave dhe parashtrësve me numër 01 nr....i dt. 27.03.2017, ka vërtetuar faktin se ankesa e paditëses për anulimin e konkursit 05 nr. ... të dt. 15.12.2016, është refuzuar me arsyetim se e njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e parapara me udhëzimin administrativ nr. 06/2015, mbi normativin e kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm konkretisht neni 5 pika 1.1. Prandaj sipas nenit 35.1 të Ligjit për arsimin para universitar drejtorët dhe zëvendës drejtorët e institucioneve arsimore, mësimdhënësit, asistentët dhe instruktorët zgjidhen për mes një konkursi publik në bazë të meritës personale, pa asnjë lloji diskriminimi të drejtë për drejtë apo të tërthorti për arsye reale apo të supozuara që ka lidhje me gjininë, racën gjendjen martesore, orientimin seksual, përkatësinë etnike, nevojat e veçanta, pasurin, vendin e lindjes, pikëpamjet politike ose filozofike, apo rrethana të tjera, e duke u bazuar në paragrafin 4 që mësimdhënësit zgjidhen nga një komision i themeluar nga DKA-së si dhe bazuar në nenin 5 pika 1.1 të Udhëzimit administrativ të MASHT-it, nr. 06/2015, ku për shkollat e mesme të ulët gjuha shqipe kërkohet kualifikimi i fakultetit të edukimit programi gjuhësor, ndërsa këtu paditësja këtë nuk e ka pasur por ka pasur të përfunduar fakultetin filologjik, dhe nuk ka prezantuar paditësja asnjë provë të besueshme se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm. Vendimin për shpenzime e bazon në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar aktgjykimin e goditur ka gjetur se nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2

pika b), g), j), k), dhe m), në të cilat kjo gjykatë shikon sipas detyrës zyrtare, e as në ato në të cilat thirret ankesa.

Thëniet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike sipas vlerësimit të kësaj gjykate paraqiten si të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se këtu paditësja nuk ka plotësuar kushtet nga udhëzimi administrativ nr. 06/2015 dhe konkretisht neni 5 pika 1.1 i cili jep përparësi në punësim kuadrat me fakultet të edukimit, pra nuk është ftuar në intervistë sepse ka pasur të kryer fakultetin filologjik e jo atë të fakultetit të edukimit. Pra, nuk është ftuar në intervistë jo vetëm paditësja po edhe të tjerët, sepse në intervistë janë ftuar dhe përzgjedhur të gjithë kandidatët të cilët kanë pasur të kryer fakultetin e edukimit si dhe kandidatja e pranuar ka pasur të përfunduar fakultetin e edukimit. Pra, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se konkursi është shpallur komfor neni 8 të Ligjit të punës, pastaj të neni 35 të Ligjit për arsimin para universitar dhe neni 5 të Ligjit mbi arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës si dhe të normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshme nr. 6/2015.

Prandaj, pran gjendjes faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë edhe të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerësoj edhe pretendimet e tjera ankimore dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk ndikojnë në marrjen e vendimit ndryshe nga ajo të cilën e ka marrë gjykata e shkallës së parë.

Nga të lartcekurat e në kuptim të neni 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.994/18, të datës 02.02.2021**

**Kryetari i kolegjit**  
Kujtim Pasuli